

VENDIM
Nr. 1, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE
MARRËVESHJES SË PJESËMARRJES NË BURSËN E ORGANIZUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 19 germa “a” dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” dhe “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Në bazë të nenit 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”: “ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj dhe modelin e tregut të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, është vendosur “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”;

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e saj nr. 7565, prot., datë 12.12.2016, paraqiti në ERE për miratim draftin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” dhe draftin e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e:

a) “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”

- Specifikimi i Produkteve – shtojca I;
- Rregullat e Tregut Shqiptar të Ditës në Avancë – shtojca II;
- Rregullat e Tregut brenda Ditës – shtojca III;
- Rregullat e Administrimit të Tregut – shtojca IV;
- Rregullat për Pagesat dhe Faturimin – shtojca V;
- Zona e Import/Eksportit – shtojca VI;
- Termat e përgjithshëm VII.

b) “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., MEI-n, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e tjera të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

